

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra, kryetar, dhe gjyqtaret profesioniste Shadije Gërguri dhe Shpresa Hasaj-Hyseni, anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. M., për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, kundër të akuzuarit B. M. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPRK-së, dhe kundër të akuzuarve R. M. dhe Sh. Sh. për shkak të veprave penale, secili veç e veç, Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit, PP.nr.455-1/10 të dt.13.09.2010, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me dt.19.08.2016, mori dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A. M., i biri i B. dhe H., e gjinisë L., i lindur më *data e lindjes...*, në K., tani me vendbanim në P., lagja e S. rr.'...' , pn., me nr. të ID *numri personal...*, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak prej dt.10.08.2010 deri me dt.10.09.2010.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Me dt.10.08.2010, rreth orës 13.15, në P., në lagjen e s. rr.'...' në afërsi të shitores "...", me dashje e në vazhdimësi ka përdorur me kërcënim dy armë të zjarrit në raport me të akuzuarin Sh. Sh., në atë mënyrë që pas një grindje me të njëjtin rreth lëshimit të rrugës për kalim të automjeteve, dhe pas fillimit të rrahjes me të njëjtin, e me qëllim të kërcënimit-frikësimit të tij, ka përdorë një pushkë të gjuetisë të tipit "Karatay", të cilën e ka mbajtur në gjendje gatishmërie e pastaj edhe me një revole të markës së panjohur, ka shtënë rreth tri herë në ajër.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 3, 34, 39, 64, 73 dhe 328 par.1 dhe 5 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 368, 450, 453 dhe 463 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalohet 6 muaj.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i konfiskohet pushka e gjuetisë të tipit "Karataj" me nr.serik 7555647, si mjet me të cilën është kryer vepra penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së

REFUZOHET AKUZA

kundër të akuzuarve A. M., R. M. dhe Sh. Sh. për veprat penale secili veç e veç Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale konform nenit 91 par.3 lidhur me nenin 90 par.1 nënpar.4 të KPK-së dhe

kundër të akuzuarit B. M. për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, për shkak se kjo veprë penale është përfshirë me amnisti, sipas nenit 3 par.1 nënpar.1.1 pika 1.1.10 të Ligjit për Amnisti.

Shpenzimet e procedurës penale për këto vepra penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Të dëmtuarit I. B. dhe A. M.1 për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP.nr.455-1/10 të dt.13.09.2010, kundër të akuzuarve A. M., B. M., R. M. dhe Sh. Sh. për shkak të veprave penale si në hyrje të këtij aktgjykimi.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, me dt.19.08.2016, dhe para se të lexohet aktakuza, trupi gjykues duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare ka vërtetuar faktin se kundër të akuzuarve A. M., R. M. dhe Sh. Sh. ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale për veprat penale, secili veç e veç, Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, derisa për të akuzuarin A. M. edhe për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së. Ndërkaq kundër të akuzuarit B. M. gjykata ka konstatuar faktin se vepra penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, është përfshirë në Ligjin për Amnistinë, ashtu që procedura penale ka vazhduar vetëm kundër të akuzuarit A. M., dhe ate vetëm për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari A. M. në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranim të kryerjes së veprës penale, pranim i cili

është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit A. M., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe t'ia shqiptoj një sanksion penal përkatës, dhe me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që t'a marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe t'a vlerësoi si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. M. av.N. Sh. në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, si rrethana lehtësuese ti ketë për bazë pranimin e fajësisë, pendimin, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin që nga koha e kryerjes së veprës penale deri më tani nuk ka ra ndesh me ligjin, më parë nuk ka qenë i gjykuar, dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale kundër të njëjtit, me palën e dëmtuar janë pajtuar, është i martuar, baba i katër fëmijëve, mbajtës i vetëm i familjes, nga të ardhurat që i siguron nga puna e tij siguron ekzistencën e familjes së tij, dhe në fund i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t'ia shqiptoj një dënim me gjobë me të cilin dënim mbrojtja vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari A. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij duke e lutur gjykatën që të njëjtit t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

Ndërkaq sa i përket veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, me të cilën vepër akuzohet të akuzuarit A. M., R. M. dhe Sh. Sh., secili veç e veç, nga të dhënat në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se të akuzuarit e lartcekur këtë vepër e kanë kryer me dt.10.08.2010. Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim deri në 3 vjet. Sipas dispozitës së nenit 90 par.1 nënpar.5 të KPK-së, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret në rast se kanë kaluar 3 vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 1 vit burgim, përkatësisht nga ndërmarrja e veprimit të fundit procedural me qëllim të ndjekjes penale të veprës penale të kryer konform nenit 91 par.3 të KPK-së. Ndërkaq nga të dhënat në shkresat e lëndës rezulton se veprimi i fundit procedural që është marrë në këtë çështje penale, është faza e konfirmimit të aktakuzës me dt.27.10.2010, dhe pas kësaj date nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër procedural. Ashtu që nga këto të dhëna rezulton se për këtë vepër penale ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale për të tre të akuzuarit dhe atë me dt.27.10.2013.

Ndërkaq sa i përket veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së me të cilën akuzohet i akuzuari A. M., për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim deri në 5 vite. Sipas dispozitës së nenit 90 par.1 nënpar.4 të KPK-së, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret në rast se kanë kaluar 5 vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 3 vjet burgim, përkatësisht nga ndërmarrja e veprimit të fundit procedural me qëllim të ndjekjes penale të veprës penale të kryer konform nenit 91 par.3 të KPK-së. Po ashtu edhe për këtë vepër penale veprimi i fundit procedural që është marrë në këtë çështje penale, është faza e konfirmimit të aktakuzës me dt.27.10.2010, dhe pas kësaj date nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër procedural. Ashtu që nga këto të dhëna rezulton se për këtë vepër penale ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale për të tre të akuzuarit dhe atë me dt.27.10.2015.

Ndërkaq sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, me të cilën akuzohet i akuzuari B. M., gjykata ka vërtetuar faktin se kjo vepër është përfshirë në Ligjin për Amnistinë Nr. 04L-209, i cili ka hyrë në fuqi me dt.04.10.2013. Sipas nenit 3 par.1 nënpar.1.1 pika 1.1.10 lirohen plotësisht nga ndjekja penale kryerësit e veprës penale Mbajtja në

pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK-së, e që sipas Kodit të vjetër penal, kjo dispozitë korrespondon plotësisht me nenin 328 par.2 të KPK-së. Sipas nenit 2 par.1 të këtij ligji, të gjithë kryerësit e veprave penale të listuara në nenin 3 të këtij ligji, të cilat janë kryer para dt.20.06.2013, lirohen plotësisht nga ndjekja penale. Nga të dhënat në shkresat e lëndës rezulton se kjo vepër penale është kryer me dt.10.08.2010, çka dmth.,se janë plotësuar kushtet ligjore, që i akuzuari B. M. të lirohet nga ndjekja penale për këtë vepër për të cilën akuzohet.

Andaj, bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, kundër të akuzuarve A. M., R. M. dhe Sh. Sh. për veprat penale secili veç e veç Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së, dhe kundër të akuzuarit B. M. për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, e ka refuzuar akuzën.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin A. M., i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 64 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sigurtë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, si dhe gjendjen ekonomike, e në mungesë të rrethanave rënduese, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 34 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin A. M., do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e reveles dhe mjeteve tjera me të cilat është kryer kjo vepër penale, është marrë konform nenit 328 par.5 të KPK-së.

Vendimi lidhur me udhëzimin e palëve të dëmtuar në kontest civil, lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë duke pas për bazë faktin se të dëmtuarit nuk kanë qenë prezent në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, e po ashtu deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e kanë precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.241/10, dt.19.08.2016

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.